

**BE-ja për drejtësi digjitale - mbështetje për
sundimin e ligjit përmes transformimit digjital.
Avancimi i kapaciteteve të menaxhimit të çështjeve
dhe inteligjencës së biznesit në Shqipëri.
(EU4Digital Justice)**

Duration: 01.11.2024 - 30.10.2028

Countries:
Albania

**EU
contribution:** € 7 500 000

**Total
budget:** € 7 500 000

Implementer:
UNOPS - United Nations Office for Project Services



Website(s): euprojects.al/euprojects/eu4digital-justice-support-to-the-rule/

Project description:

Projekti "BE-ja për drejtësi digjitale" është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian, e zbatuar nga UNOPS-i në kuadër të IPA III, gjithsej me një buxhet prej 7.5 milionë eurosh, i cili synon avancimin e transformimit digjital të sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Gjatë 48 muajve, projekti fokusohet në forcimin e sundimit të ligjit, duke përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe performancën e institucioneve gjyqësore.

Në thelb, projekti mbështet zhvillimin e një sistemi modern dhe të ndërveprueshëm të menaxhimit të çështjeve për prokuroritë e përgjithshme, rrit kapacitetet operacionale dhe teknike të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë dhe prezanton mjete të avancuara të statistikave dhe inteligjencës së biznesit, për të mundësuar vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Përmes asistencës teknike të synuar dhe modernizimit të sistemeve, projekti " BE-ja për drejtësi digjitale" synon të thjeshtojë proceset, të përmirësojë koordinimin institucional dhe të ofrojë shërbime drejtësie më të shpejta dhe më transparente, në përputhje me standardet e BE-së. Kjo iniciativë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një sistemi drejtësie më efektiv, llogaridhënës dhe të mundësuar digjitalisht në Shqipëri.

Rruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE përfshin një transformim thelbësor të sistemit të saj të drejtësisë. Projekti "BE-ja për drejtësi digjitale" synon të adresojë sfidat kryesore në ofrimin e shërbimeve të drejtësisë në Shqipëri përmes inovacionit teknologjik dhe forcimit institucional.

Expected results:

- Qendra e Teknologjisë së Informacionit e avancuar në zbatimin e hartës së rrugës dhe kuadrit të ndërveprueshmërisë për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri;
- sistemi i menaxhimit të çështjeve për prokuroritë i ndërtuar dhe funksional;
- sistemi i statistikave dhe inteligjencës së biznesit i ndërtuar dhe funksional.